

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN– Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ardijana Reshtani– sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.B. nga ..... , për shkak të veprave penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 nën. par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK dhe vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën. par.1.1 të KPRK, i akuzuari sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.515/13 të datës 16.07.2013, pas mbajtjes së seancës fillestare, në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarit dhe të dëmtuarit Sh.S. , me datë 14.04.2017, publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**V.B.** nga i ati N. dhe e ëma B. , e lindur P. , i lindur më “i lindur me ...” në ..... , ku edhe jeton, në rr. “ ..... “ nr. . , student, i fejuar, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal të letërnjoftimit ..... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**I.** Se gjatë datës 05.02.2013 – 06.02.2013, në orët e vona të natës, në Prizren, në rrugën “..... “ nr. .. , së bashku me të akuzuarin E.Sh. , me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, ia marrinë pasurinë e luajtshme të dëmtuarit Sh.S. , në atë mënyrë që paraprakisht mirren vesh mes veti, e shfrytëzojnë momentin e volitshëm, orët e vona të natës dhe mos prezencën e punëtorëve, me përdorimin e forcës thyejnë derën e lokalit “ ..... “, pronë e të dëmtuarit Sh.S. , hyjnë brenda dhe nga aty marrin një llap – top ngjyrë të zezë model ACER A..... , një llap – top të markës “ Gateway “ ngjyrë të zezë dhe një llap–top “ Usus “, ngjyrë të bardhë, të cilat më pas iu shesin personave tjerë.

**Kësodore në bashkëkryerje ka kryer veprën penale nga neni 327 par.1 nën. par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK.**

**II.** Gjatë datës 24.02.2013-25.02.2013, në kohë të papërcaktuar, në Prizren, në rrugën “ ..... “, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, merr pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mosprezencën e punëtorëve, duke depërtuar me forcë në hapësirat e mbyllura, me mjet të përshtatshëm thyen derën e lokalit për servisimin e llap – topëve “ ..... “, pronë e të dëmtuarit A.H. dhe nga aty merre disa llap – top të markave të ndryshme të cilat më pas iu shet personave tjerë.

**Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë neni 327 par.1 nën. par.1.1 të KPRK.**

Gjykata në bazë të neneve të lartpërmendura dhe neneve 4, 7, 17, 41, 45, 46, 73, 75, 83 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin e:

## G J Y K O N

-Për veprën penale nën I. të dispozitivit, me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqindë) euro dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

-Për veprën penale nën II. të dispozitivit, me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqindë) euro dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Në kuptim të nenit 80 par.1 dhe par.2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPRK, të akuzuarit ia shqipton:

-Dënimin unik me gjobë në shumë prej **600 (gjashtëqindë) euro**, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë (20) € gjobë, respektivisht tridhjetë (30) ditë burgim dhe,

-Dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) vit e 8 (tetë) muaj**, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.03.2013 e deri me datën 21.03.2013.

Të dëmtuarit A.( Sh.)H. nga fshati ..... - Komuna e Rahovecit dhe Sh.(N.)S. nga ..... , rr. “ .... ” nr. .. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë paushallin gjyqësor në lartësi prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.nr.515/13 të datës 16.07.2013, ndaj të akuzuarve E.Sh. dhe V.B. që të dy nga ..... , për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë të kryer në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 nën. par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK, ndërsa i akuzuari V.B. edhe për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën. par.1.1 të KPRK.

Kjo gjykatë me datën 24.07.2016, ka marrë aktvendim për veçim të procedurës në kuptim të nenit 36 të KPRK, për të akuzuarin E.Sh., meqenëse prezenca e të njëjtit nuk ka mundur të sigurohet.

I akuzuari V.B. në shqyrtimin fillestar të dt.14.04.2017, ka pranuar fajësinë për veprat penale, vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 nën. par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK dhe vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën. par.1.1 të KPRK, sipas aktakuzës së PTH-së në Prizren.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua, se i akuzuari V.B. gjatë datës 05.02.2013 – 06.02.2013, në orët e vona të natës, në ..... , në rrugën “..... ..” nr. .. , së bashku me të akuzuarin E.Sh. , me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, ia marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit Sh.S. , në atë mënyrë që paraprakisht mirren vesh mes veti, e shfrytëzojnë momentin e volitshëm, orët e vona të natës dhe mos prezencën e punëtorëve, me përdorimin e forcës thyejnë derën e lokalit “ ..... ..”, pronë e të dëmtuarit Sh.S., hyjnë brenda dhe nga aty marrin një llap – top ngjyrë të zezë model ACER A..... , një llap – top të markës “ Gateway “ ngjyrë të zezë dhe një llap–top “ Usus “, ngjyrë të bardhë, të cilat më pas iu shesin personave tjerë.

Po ashtu është vërtetuar në tërësi, se i akuzuari V.B. , gjatë datës 24.02.2013-25.02.2013, në kohë të papërcaktuar, në ..... , në rrugën “ ..... ..”, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, merr pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mosprezencën e punëtorëve, duke depërtuar me forcë në hapësirat e mbyllura, me mjet të përshtatshëm thyen derën e lokalit për servisimin e llap – topëve “ ..... ..”, pronë e të dëmtuarit A. H. dhe nga aty merre disa llap–top të markave të ndryshme të cilat më pas iu shet personave tjerë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit V.B. për veprimet e tij të përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprat penale me të cilat ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza me ç’ rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat në shqyrtimin fillestar nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekutar më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit, duke i shqiptuar dënimet si në dispozitiv të aktgjykimit e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, bashkëpunimin e tij me organet e ndjekjes si dhe qëndrimin e tij korrekt në procesin gjyqësor gjatë gjithë procedurës, faktin se të dëmtuarit Sh.S. të gjitha gjësendet i janë kthyer (deklarimi i tij gjatë seancës fillestare), kurse në rastin konkret gjykata gjeti se kemi të bëjmë me rrethana posaqërisht lehtësuese, në pajtim me nenin 75 të KP-së për zbutjen e dënimit, të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare që nga fillimi i kësaj procedure penale. Ndërkaq si rrethana rënduese gjykata mori parasysh intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin që i akuzuari duke vepruar me dashje në mënyrë të rrezikshme dhe të vrazhdë, cenon pasurinë e të dëmtuarve duke ua shkelur një të drejtë themelore të njeriut, e mbrojtur edhe me të drejtën ndërkombëtare, ashtu që pas analizimit të gjitha rrethanave, gjykata erdhi në përfundim dhe të akuzuarit i shqiptoi dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është në harmoni me intenzitetin e rrezikshmërisë shoqërore dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit me bindje se me këto lloj dënimesh do të arrihet qëllimi i dënimit duke përfshirë preventivën individuale dhe atë të përgjithshme si dhe do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.2

të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.98/2017 të datës 14.04.2017**

**Sekretarja juridike**  
**Ardijana Reshtani**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**  
**Sadije Selmani**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.